



Agencia për Zhvillim Rajonal-Qendër
Agencia za Regionalni Razvoj-Centar
Regional Development Agency-Center

INVESTIMET PUBLIKE NË RAJONIN QENDËR (RAPORT HULUMTUES)



Prishtinë, Qershor 2019

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Decentralizimi fiskal në Kosovë: implikimet për investime kapitale në Komuna	4
3. Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara në komunat e Rajonit Ekonomik Qendër	6
4. Shpenzimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara në komunat e rajonit qendër, sipas sektorëve	9
5. Projektet kapitale të financuara nga qeveria që ndrore	11
6. Konkluzione dhe Rekomandime	13
Literatura:	14
Shtojca 1: Numri i banorëve në komunat e rajonit qendër (2013-2018)	15
Shtojca 2: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara – Komuna e Prishtinës	16
Shtojca 3: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara – Komuna e Podujevës	17
Shtojca 4: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara – Komuna e Fushë Kosovës.....	18
Shtojca 5: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara – Komuna e Lipjanit	19
Shtojca 6: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara – Komuna e Drenasit	20
Shtojca 7: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara – Komuna e Obiliq.....	21
Shtojca 8: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara – Komuna e Gracanicës	22
Shtojca 9: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara – Komuna e Shtimes	23

1. Hyrje

Investimet kapitale luajnë një rol kyç në realizimin e prioriteteve strategjike të komunave. Këto prioritete strategjike të komunave burojnë nga strategjitë komunale të cilat janë të bazuara në kërkesat e qytetarëve të cilat janë të reflektuara në strategji zhvillimore komunale. Për ti realizuar këto prioritete strategjike me sukses nevojitet një menaxhim efikas dhe transparent i financave publike në përputhje me kompetencat e komunave.

Litratura e menaxhimit të financave publike ndërton argumente se decentralizimi ndikon në menaxhim me efikas të parasë publike dhe të realizimit të projekteve kapitale (Bahl & Bird, 2013; Frank, & Martinez-Vazquez, 2014). Këto argumente kryesisht lidhen me mundësinë e realizimit të efikasitetit teknike dhe alokative, rritjen e mirëqënies për popullsinë lokale, realizimi i nevojave dhe kërkesave lokale, përmirësimi i llogaridhënies si dhe kontrollit më të madh mbi shpenzimet. Për shembull, çështjet si infrastruktura lokale dhe ofrimi i shërbimeve publike janë shumë të rëndësishme për zhvillimin lokal dhe ekonominë lokale.

Pikërisht, me qëllim të rritjes së efikasitetit, roli i komunave në menaxhimin e parasë publike është rritur edhe në Kosovë. Roli i shtuar i komunave ka ndryshuar edhe raportin kompleks të autoritetit mbi shpenzimet publike ndërmjet komunave dhe nivelit qendror. Edhe pse, Qeveria e Kosovës ende është përgjegjëse për pjesën më të madhe të investimeve publike, autoritetet lokale janë duke i rritur përgjegjësitë lidhur me investimet kapitale, në harmoni me politikën e decentralizimit të qeverisjes së Kosovës. Për kundër rritjes së përgjegjësisë të autoriteteve lokale, niveli i investimeve kapitale dhe roli i autoriteteve lokale në menaxhimin e financave publike është shumë i ndryshëm nga modelet që vijnë nga Bashkimit Evropian. Për shembull në Kosovë vlera e investimeve kapitale të komunave nuk e kalon 1/5 e vlerës së përgjithshme të investimeve totale të qeverisë (IMF, 2016), ndërsa në Bashkimin Evropian, autoritetet lokale dhe regjionale janë përgjegjëse për gjysmën e buxhetit të përgjithshëm për investimet publike (European Commission, 2017).

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që të pasqyrojë investimet kapitale në komunat e Rajonit Ekonomik Qendër gjatë periudhës 2013-2018 dhe të vlerësojë kapacitetin investues të autoriteteve lokale në realizimin e projekteve kapitale me qëllim të arritjes së prioriteteve të tyre zhvillimore. Për më tepër, ky raport do të paraqesë ndryshimet në investimet kapitale gjatë kohës, ndikimin e tyre, krahasimin e këtyre investimeve kapitale në raport me numrin e banorëve në komunat përkatëse, si dhe nëse komunat kanë marrë kompetenca shtesë pa buxhet adekuat.

2. Decentralizimi fiskal në Kosovë: implikimet për investime kapitale në Komuna

Edhe pse Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në decentralizimin fiskal, duke i rritur komeptencat e komunave në menaxhimin e parasë publike, sfidë permanente mbeten kapacitet buxhetore për të përmbushur objektivat zhvillimore. Komunat si organizata buxhetore financohen nga grantet qeveritare (grantin specifik, grantin e arsimit, dhe atë të shëndetësisë) dhe të hyrat vetanake. Këto përbëjnë të hyrat buxhetore të komunës që pastaj alokohen nëpërmjet buxhetit në formë të shpenzimeve në kategori të ndryshme (paga dhe medijtje, mallra dhe shërbime, shpenzime për komuna, subvencione dhe transfere, dhe shpenzimet kapitale) të cilat përbëjnë pjesën më të konsiderueshme të buxhetit. Sipas Ligjit për Menaxhim të Financave Publike në Kosovë, shpërndarja e mjeteve buxhetore bëhet përmes qarkoreve buxhetore ku organizatat buxhetore, përfshirë komunat, u ndahen grantet qeveritare dhe ju caktohet buxheti për një vit fiskal. E gjithë kjo më qëllim të ruajtjes së stabilitetit fiskal dhe buxhetor. Mirëpo, sipas INPO (2015) përpjekja për të mbajtur nën kontroll organizatat buxhetore edhe në planifikimin e të hyrave vetanake e vështirëson efikasitetin e menaxhimit të parasë publike, dhe si rrjedhojë ka komuna të cilat mund të inkasojnë më shumë të hyra se që janë planifikuar, sikur rasti i Komunës së Prishtinës.

Edhe procesi i marrjes së vendimeve për investime kapitale në komuna nuk është i qartë dhe shpesh nuk është i kordinuar mirë me nivelin qendror. Në fushën arsimit, vendimmarrja është e fragmentuar ndërmjet qeverisë qendrore dhe komunave. Për shembull, Ministria e Arsimit është përgjegjëse për ndërtimin e shkollave, por jo për mirëmbajtjen e tyre, e cila është përgjegjësi e komunave. Kjo dëshmon nevojën për ndryshimet që duhet të ndodhin lidhur me përgjegjësitë në mënyrë që komunave t'u ofrohet një kompetencë më e madhe krahas decentralizimit të qeverisjes dhe obligimeve që dalin nga ky dencentralizim karshi kërkesave të qytetarëve.

I tërë ky proces i transfereve në komuna për qëllime investimi nuk është i bazuar në rregulla, edhe pse konsiderohet si transparent (IMF, 2016). Sipas ligjit ekzistojnë tri lloje kryesore të transfereve qeveritare: grante të përgjithshme, grantet specifike të kujdesit shëndetësor, dhe grantet specifike të arsimit, por nuk bëhen transferime specifike kapitale nga qeveria qendrore në komuna. Ligji për financa publike definon kriteret për alokimin e këtyre transfereve tek komunat, bazuar në disa parametra siç janë: popullsia, madhësia territoriale, numri i shërbimeve të ofruara. Komunat marrin këto grante për të mbuluar si shpenzimet për mallra dhe atë të shpenzimeve kapitale, së bashku me burimet e tyre të të ardhurave. Sipas vlerësimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (2016, f. 21) komunat mund të përdorin për qëllime specifike grante për financimin ose bashkëfinancimin e projekteve investuese në kujdesin shëndetësor ose arsimin që janë të menaxhuara nga ministritë e linjës, por këto transfere specifike nuk ndjekin një rregull të paracaktuar ose mekanizëm të bazuar në rregulla.

Sipas IMF (2016), komunat nuk kanë të zhvilluar mirë teknikat e buxhetimit (costing) të nevojshme për të përgatitur informacione komplete për implikimet e tyre fiskale afatmesme dhe shpenzimet kapitale. Sipas të dhënave dhe observimeve të fundit, vërehet se parashikimi

lidhur me të hyrat komunale janë shumë optimiste, gjë që rezultojnë në efikasitetin e ultë të implementimit të projekteve kapitale. Rrjedhimisht, kjo ndikon edhe në realizimin e ultë të objektivave zhvillimore të parapara me strategji zhvillimore lokale të komunave përkatëse. Në këtë kontekst, nevojitet rikthimi i parametrin që ka të bëjë me shpenzimin e buxhetit aktual si parametër vlerësues në shpërndarjen e buxhetit vijues. Kjo rregull që ka ekzistuar prej disa viteve ka ndikuar si stimulim tek autoritete lokale që të planifikojnë më mirë implementimin e projekteve kapitale.

Borxhi publik, paraqet një burim tjetër të financimit të projekteve kapitale. Sipas ligjeve në fuqi, edhe komunat kanë të drejtë të hyjnë në borxh publik për të rritur buxhetin për investime kapitale. Megjithatë, ligji specifikon që çdo kërkesë për të hyrë në borxh publik, komuna duhet ta adresojë tek Ministria e Financave për aprovim.¹ Ligji mbi Borxhin Publik kufizon borxhin e përgjithshëm të komunave - kufijtë për borxhin e përgjithshëm bruto të komunave, duke përfshirë garancitë, duhet të mos kalojë 40 përqind të të hyrave vetanke dhe granteve të përgjithshme. Ky ligj përcakton kufizime shtesë për afat të shkurtër dhe afatgjatë të borxhit komunal, por nuk përcaktohen kufizime huamarrëse ose rregulla që lidhen posaçërisht me investimet.

Një alternativë tjetër e financimit komunal, mbetet financimi i projekteve kapitale përmes së partneritetit publiko-privat (PPP). Sipas Ligjit për Partneritet Publiko-Privat në Kosovë² komunat kanë mundësi të inicimit të projekteve me financim PPP. Megjithatë, Komiteti për Partneritete Publiko-Private (KPPP) është në kuadër të Ministrisë së Financave dhe komunat kanë kompetenca të limituar për vendimmarrje lidhur me një projekt të PPP. Në harmoni me ligjin për PPP është krijuar struktura institucionale për zbatimin dhe menaxhimin e PPP-ve. Organi kryesor është Komiteti i PPP (KPPP), i cili përbëhet nga 5 anëtarët e përhershëm, të cilët janë Ministri i Financave, që është edhe kryesuesi i Komitetit, dhe Ministri i Infrastrukturës, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe Kryeministri. Ligji gjithashtu identifikon edhe një anëtar të përkohshëm, i cili është përfaqësues i Autoritetit Publik që është identifikuar si Autoriteti Kontraktues për projektin.

3

Sipas Ligjit, të gjitha projektet PPP, duhet t'i nënshtrohen miratimit formal nga KPPP para se Autoriteti Publik të iniciojë çfarëdo procedure tenderimi. Miratimi nga KPPP jepet ose refuzohet në bazë të shqyrtimit të studimit të arsyeshmërisë, dokumenteve tjera që ndërlidhen me projektin, dhe rekomandimit të Departamentit PPP. Në rast të shqyrtimit të projekteve që kanë të bëjnë me shërbime publike komunale, KPPP miraton projektin nëse plotësohen kriteret si në vijim: 4.1. projekti është në kuadër të kompetencave komunale të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, 4.2. komuna e ka siguruar financimin adekuat për implementimin e projektit, dhe 4.3. komuna e ka siguruar një ndarje adekuate të

¹ LAW Nr.03/L- 175 LAW ON PUBLIC DEBT

² LIGJI Nr. 04/L-045 PËR PARTNERITET PUBLIKO PRIVAT

³ P.sh. në rast se bëhet fjalë për një projekt komunal, atëherë Komiteti PPP përveç anëtarëve të përhershëm, në përbërje do të ketë edhe një përfaqësues nga Komuna e cila implementon projektin në shqyrtim.

rezikut midis sektorit privat dhe atij publik.⁴ Në përfundim, nevojitet një asistencë më e madhe teknike në ngritjen e kapaciteteve të komunave për të inicuar projekte me PPP në mënyrë që të realizohen objektivat zhvillimore. Marrja në konsideratë e të gjithë këtyre faktorëve do të ndikojë në parashikim më të mirë të investimeve kapitale si dhe mundësitë e financimit të tyre.

3. Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara në komunat e Rajonit Ekonomik Qendër

Në këtë seksion prezantohen investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara në komunat e rajonit qendër: Prishtina, Podujeva, Fushë Kosova, Obiliqi, Shtimja, Lipjani dhe Gracanica. Investimet e planifikuara dhe të realizuara mundësojnë krahasimin ndërmjet komunave në lidhje me performancën në menaxhimin e projekteve kapitale si dhe do të mundësojnë vlerësimin e potencialit investues të komunave që do të pasqyrojë mundësitë për të plotësuar nevojat e qytetarëve. Siç shihet nga të dhënat e prezantuara në Tabelën 1, në vitin 2018, rajoni qendër ka pasur një buxhet të përgjithshëm të planifikuar për financimin e investimeve kapitale në vlerë prej 153,683,917 €, ndërsa janë realizuar vetëm 51,579,606 €. Kjo tregon për një efikasitet jo të kënaqshëm të menaxhimit të investimeve kapitale në komuna. Në vitin 2018, vetëm 33,6% të investimeve të planifikuara kapitale janë realizuara. Performanca jo e kënaqshme e komunave të rajonit qendër në realizimin e projekteve kapitale rrjedhë kryesisht nga mos-efikasiteti i komunës së Prishtinës dhe buxhetit të lartë të planifikuar, e cila ka realizuar vetëm 24,954,207 € nga 72,273,904 € të buxhetit të planifikuar apo vetëm 34.5%. Në figurën 2 janë paraqitur edhe të dhëna tjera të realizueshmërisë së buxhetit të planifikuar. Këto të dhëna tregojnë se komuna e Graçanicës për shkak të volumit më të vogël të investimeve ka arritur shkallën më të lartë të realizueshmërisë së buxhetit të planifikuar për investime kapitale në vitin 2018.

⁴ Dy shembuj të projekteve kapitale të financuar me PPP janë: shërbimet e transportit publik në Komunën e Pejës dhe PPP për përpunimin e mbeturinave urbane në Komunën e Suharekës.

Tabela 1:




Figura 1: Realizimi i buxhetit te planifikuar, ne % (2018)

Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara (në Euro) në komunat e rajonit qendër (2013-2018)

Komunat	2013		2014		2015		2016		2017		2018	
	Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Prishtine	63,371,730	34,949,000	63,443,190		57,467,233	24,382,013	65,883,762	19,750,829	62,023,630	17,721,619	72,273,904	24,954,207
Podujeve	16,521,349	5,645,250	17,050,435	5,568,335	18,306,493	4,767,312	18,446,798	4,495,404	19,284,789	4,899,845	21,372,177	6,489,514
Fushe Kosove	6,443,554	2,220,825	7,335,045		8,011,259	2,734,062	8,578,620	2,557,016	9,540,735	2,935,000	10,374,306	4,429,886
Obiliq	4,530,981	1,122,232	4,567,669	1,358,882	5,046,182	1,231,072	5,226,547	1,231,381	6,061,078	1,521,228	6,851,925	2,164,290
Lipjan	11,993,341	3,331,198	11,333,444	2,858,763	12,399,252	3,089,603	12,994,838	3,024,200	14,025,258	3,742,000	14,025,258	3,868,633
Drenas	9,616,607	2,454,000	10,982,419	2,811,208	12,118,623	3,418,537	12,118,623	2,403,663	13,141,239	3,064,358	14,477,299	4,395,350
Gracanice	5,708,467	1,919,847	5,557,378	1,677,140	6,083,185	2,341,232	6,028,934	2,183,480	7,134,075	2,894,220	7,484,556	3,566,066
Shtime	4,786,567	1,382,000	5,360,257	1,490,419	5,871,655	1,333,966	5,990,385	1,489,000	6,364,152	1,584,000	6,824,492	1,711,660
Gjithsej	122,972,596	53,024,352	125,629,837	15,764,747	125,303,882	43,297,797	135,268,507	37,134,973	137,574,956	38,362,270	153,683,917	51,579,606

Burimi: Departamenti i Buxhetit, Ministria e Financave, 2019

Në anën tjetër, për sa i përket shpenzimeve kapitale, të dhënat tregojnë se në të gjitha komunat ka pasur një rritje në tre vitet e fundit me përjashtim të Komunës së Prishtinës, ku vlera e investimeve kapitale të realizuara në vitin 2018 (24,954,207 €) në raport me vitin 2016 (19,750,829 €) është dukshëm më e vogël.




Figura 2: Shpenzimet kapitale në komunat e rajonit qendër 2013-2018

Për të hulumtuar më hollësisht alokimin e investimeve kapitale në komuna, ne kemi bërë kalkulimin e investimeve të planifikuara kapitale për kokë banori (Tabela 2). Të dhënat tregojnë se Graçanica është komuna që ka pasur investime të planifikuara për kokë banori më së shumti në periudhën 2013-2017. Pas Graçanicës, Prishtina është komuna e dytë që ka pasur investime më të mëdha për kokë banori që variron prej 281 Euro në 2017 deri në 318 Euro në vitin 2018.

Tabela 2: Buxheti i planifikuar për investime kapitale për kokë banori, në Euro (2013-2017)

Komunat	2013	2014	2015	2016	2017
Prishtine	304	306	281	318	295
Podujeve	182	196	219	218	229
Fushe Kosove	172	194	216	228	248
Obiliq	203	217	263	269	315
Lipjan	201	194	219	226	243
Drenas	99	181	199	199	214
Gracanice	511	474	511	505	594
Shtime	168	188	208	216	228

Burimi: Kalkulimi i autorëve në bazë të të dhënave të buxhetit të Kosovës dhe Agjencionit të Statistikave të Kosovës.
Vërejtje: Kalkulimi në tabelë është bazuar në të dhënat e popullësisë të ASK-së (Tabela A1 në Shtojcë)

4. Shpenzimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara në komunat e rajonit qendër, sipas sektorëve

Në Tabelën 3 (Seksioni A dhe B) janë paraqitur të dhënat lidhur me buxhetin e planifikuar dhe atë të realizuar sipas fushave Arsimi dhe Shkenca, Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural, Buxhet dhe Financa , Kultura Rinia dhe Sportet, Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale, Administrata dhe Personeli, Planifikimi urban dhe mjedisi, si dhe kategori të tjera. Buxheti më i madh i planifikuar është ndarë për arsim dhe shkencë, pastaj Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale si dhe Administrata dhe Personeli. Në kuadër të kategorisë Arsimi dhe Shkenca pjesëmarrje më të lartë në buxhetin e planifikuar e ka Komuna e Prishtinës, Podujevës dhe Lipjanit. Pothuajse e njejta renditje e pjesëmarrjes paraqitet edhe në kategorinë Shëndetësia dhe Mirëqenia sociale në të cilën prinë prapë Komuna e Prishtinës, Podujevës, dhe Fushë Kosovës. Arsimi dhe Shkenca poashtu prin sa i përket shpenzimeve kapitale të planifikuara për kokë banori (103 Euro) dhe Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (37 Euro). Këto të dhëna tregojnë për nevojën e rritjes së kapaciteteve buxhetore për rajonin qendër.

Tabela 3: Buxheti i planifikuar dhe i realizuar per investime kapitale sipas sektorëve, në Euro (2018)

A. <u>TE PLANIFIKUARA</u>	Arsimi dhe Shkenca	Bujqesia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	Buxhet dhe financa	Kulture, Rinia dhe Sportet	Shendetesia dhe Mireqenia Sociale	Administrata dhe personeli	Planifikimi urban dhe mjedisi	Tjera
Prishtine	24,508,750	1,176,810	942,155	2,790,000	9,661,250	10,904,315	291,000	21,999,624
Podujeve	9,684,685	430,209	151,245	411,069	2,861,853	893,829	3,142,016	3,797,271
Fushe Kosove	3,758,399	196,001	576,010	524,702	1,523,855	545,893	1,078,643	3,249,446
Obiliq	2,787,083	73,080	73,039	239,057	771,080	293,413	595,894	2,001,587
Lipjan	6,904,180	170,235	109,399	517,099	1,691,887	376,045	179,485	4,076,928
Gracanice	1,824,495	40,477	57,641	99,485	1,508,361	1,074,762	1,513,944	1,365,391
Shtime	3,085,287	65,982	79,680	109,530	856,103	313,765	1,074,027	1,240,118
Gjithësej	52,552,879	2,152,794	1,989,169	4,690,942	18,874,389	14,402,022	7,875,009	37,730,365

B. <u>TE REALIZUARA</u>	Arsimi dhe Shkenca	Bujqesia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	Buxhet dhe financa	Kulture, Rinia dhe Sportet	Shendetesia dhe Mireqenia Sociale	Administrata dhe personeli	Planifikimi urban dhe mjedisi	Tjera
Prishtine	1,480,000	650,000	500,000	1,683,000	1,810,000	435,000	83,000	18,313,207
Podujeve	432,523	-	-	222,047	404,700	8,000	3,061,562	2,360,682
Fushe Kosove	3,759,399	196,001	576,010	524,702	1,523,855 €	545,893	1,078,643	2,170,803
Drenas	6,471,893	165,424	97,838	348,852	1,665,610	318,080	1,563,362	977,240
Obiliq	2,787,083	73,080	75,039	239,057	771,080	293,413	595,894	2,017,279
Lipjan	6,904,180	170,235	109,399	517,099	1,691,887	376,045	179,485	4,076,928
Gracanice	1,824,495	40,477	57,641	99,485	1,508,361	1,074,762	1,513,944	1,365,391
Shtime	3,085,287	65,982	79,680	109,530	856,103	313,765	1,074,027	1,240,118
Gjithësej	26,744,860	1,361,199	1,495,607	3,743,772	10,231,596	3,364,958	9,149,917	32,521,648

Burimi: Kalkulimi i autorëve në bazë të të dhënave të buxhetit të Kosovë




Figura 3: Shpenzimet kapitale te planifikuara për kokë banori në komunat e rajonit qendër për 2018

Burimi: Kalkulimi i autorëve në bazë të të dhënave të buxhetit të Kosovës dhe Agjencionit të Statistikave të Kosovës

5. Projektet kapitale te financuara nga qeveria që ndrore

Ne Tabelën 4 janë paraqitur të dhënat për shpenzimet kapitale të financuara nga qeveria qëndrore, konkretisht sipas digasterëve të qeverisë. Ministria e Infrastrukturës ka pjesëmarrjen më të madhe të shpenzimeve kapitale në rajonin qendër (mbi 93%), pastaj Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (3.3%) dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2%). Diagsterët tjera të qeverisë, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Pushtetit Lokal përbëjnë më pak se 1% të shpenzimeve të përgjithshme kapitale në rajonin qendër. Për nga shpërndarja komunale, Prishtina ka absorbuar mbi 92% të investimeve të përgjithshme kapitale në rajonin qendër.

Tabela 4: Projektet kapitale sipas ministrive, në Euro (2018)

KOMUNAT	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	Ministria e Integrimit Evropian	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor	Ministria e Punëve të Brendshme	Ministria e Shëndetësisë	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Ministria për Komunitet dhe Kthim	Ministria e Administratës Publike	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	Ministria e Financave	Ministria e Infrastrukturas	Ministria e Kulturës, Rimisë dhe Sportit	Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale	Ministria e Punëve të Jashtme	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Ministria e Zhvillimit Rajonal	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	Gjithsej	% e gjithsej projekteve kapitale
Prishtinë	0	0	0	0	0	3,010,000	0	0	0	0	40,000	0	0	0	181,020,348	5,354,000	30,000	0	0	0	0	189,454,348	92.00
Drenas	0	0	0	0	0	420,000	0	0	0	0	556,000	46,131	0	0	0	127,000	0	0	0	0	0	1,149,131	0.56
Fushë Kosovë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	120,000	0	0	10,000,000	0	0	0	0	0	0	10,120,000	4.91
Graçanicë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	436,657	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	436,657	0.21
Lipjan	0	0	620	0	0	400,000	0	0	0	0	0	0	0	0	1,028,721	801,000	0	0	0	0	0	2,230,341	1.08
Obiliq	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	175,000	0	0	110,330	250,000	0	0	0	0	0	535,330	0.26
Podujevë	300,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	175,000	0	0	293,782	0	30,000	0	0	0	0	798,782	0.39
Shtime	0	0	0	0	0	251,000	0	0	0	0	180,000	350,000	0	0	259,465	160,634	0	0	0	0	0	1,201,099	0.58
Gjithsejt	300,000	0	620	0	0	4,081,000	0	0	0	0	1,212,657	866,131	0	0	192,712,646	6,692,634	60,000	0	0	0	0	205,925,688	100.00
% sipas ministrive	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	2.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.6	0.4	0.0	0.0	93.6	3.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	100.0	

Burimi: Minsitria e Zhvillimit Rajonal (2019)

6. Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport pasqyron investimet kapitale në komunat e rajonit qendër. Analiza e shpenzimeve kapitale të buxhetuara dhe të realizuara tregon për një performancë jo të kënaqshme lidhur me realizimin e projekteve kapitale.

Poashtu, procesi i marrjes së vendimeve për investime kapitale në komuna nuk është i qartë dhe jo rrallë është i pakoordinuar si duhet me nivelin qendror. Raporti tregon edhe për një kapacitet buxhetor të limituar kundrejt nevojave të qytetarëve në rritje i cili vërehet edhe me investimet e ulëta për kokë banori.

Rrjedhimisht, komunat duhet të gjejnë mënyra alternative për të financuar projektet kapitale prej granteve dhe të hyrave vetanake. Borxhi publik dhe investimet me partneritet publiko-privat mbeten alternativa të përshtatshme të financimit. Megjithatë, tek buxheti publik komunat duhet të bëjnë kërkesë direkte për të hyrë në borxh publik, dhe procedurat mund të ndikojnë në ngadalësimin e procesit të hyrjes në borxh publik.

Lidhur me PPP, komunat mund të hyjnë në këto projekte mirëpo janë të limituara vetëm në ato fusha ku ka interesim sektori privat. Edhe procedurat për PPP parashohin koordinim të ngushtë me qeverinë dhe aprovim nga komiteti ndër-ministor që nganjëherë edhe e ngadalësojnë procesin e realizimit të PPP-së. Në fund, nevojitet një përkrahje më e madhe e komunave në ngritjen e kapaciteteve lidhur me teknikat e kostimit, buxhetimit, prokurorimit, dhe menaxhimit të projekteve në përgjithësi.

Literatura:

- Bahl, R., & Bird, R. M. (2013). *Decentralization and infrastructure in developing countries: reconciling principles and practice* (No. 16). University of Toronto, Institute on Municipal Finance and Governance.
- European Commission. (2018), "Government investment in the EU: the role of institutional factors in Report on Public Finances in EMU 2017". [Online] Available: https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/economy-finance/ip069_en.pdf .
- Frank, J., & Martinez-Vazquez, J. (2014). *Decentralization and infrastructure: from gaps to solutions*.
- IMF (2016), Republic of Kosovo Technical Assistance Report—Public Investment Management Assessment, WDC: International Monetary Fund.
- INPO (2015). (Pa)qëndrueshmëria financiare e komunave, Prishtinë: Iniciativa për Progress (INPO).
- Nenkova, P., & Kalcheva, D. (2018). Bulgarian Municipalities' Capacity to Invest and Factors Affecting Local Government Capital Spending for the Period 2003-2017. *Godishnik na UNSS*, (1), 141-155.

Shtojca 1: Numri i banorëve në komunat e rajonit qendër (2013-2018)

Komunat	2013	2014	2015	2016	2017
Prishtine	208,230	207,062	204,721	207,313	210,282
Podujeve	90,568	86,836	83,425	84,503	84,223
Fushe Kosove	37,514	37,735	37,048	37,591	38,475
Obiliq	22,309	21,056	19,165	19,440	19,262
Lipjan	59,773	58,373	56,643	57,415	57,815
Drenas	97,127	60,838	60,946	60,909	61,318
Novoberde	6,905	6,942	6,973	6,993	7,08
Gracanica	11,178	11,720	11,900	11,931	12,006
Shtime	28,369	28,491	28,181	27,627	27,864

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019

Shtojca 2: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara – Komuna e Prishtinës

	Prishtinë	
	Te Planifikuara	Te Realizuara
2013	63,371,730	34,949,000
2014	63,443,190	
2015	57,467,233	24,382,013
2016	65,883,762	19,750,829
2017	62,023,630	17,721,619
2018	72,273,904	24,954,207
Gjithsej	384,463,449	104,036,049

Burimi: Departamenti i Buxhetit, MEF, 2019

Shtojca 3: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara – Komuna e Podujevës

	Podujevë	
	Te Planifikuara	Te Realizuara
2013	16,521,349	5,645,250
2014	17,050,435	5,568,335
2015	18,306,493	4,767,312
2016	18,446,798	4,495,404
2017	19,284,789	4,899,845
2018	21,372,177	6,489,514
Gjithsej	110,982,041	31,865,661

Burimi: Departamenti i Buxhetit, MEF, 2019

Shtojca 4: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara –
Komuna e Fushë Kosovës

	Fushë Kosovë	
	Te Planifikuara	Te Realizuara
2013	6,443,554	2,220,825
2014	7,335,045	
2015	8,011,259	2,734,062
2016	8,578,620	2,557,016
2017	9,540,735	2,935,000
2018	10,374,306	4,429,886
Gjithsej	50,283,519	14,876,789

Burimi: Departamenti i Buxhetit, MEF, 2019

Shtojca 5: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara – Komuna e Lipjanit

	Lipjan	
	Te Planifikuara	Te Realizuara
2013	11,993,341	3,331,198
2014	11,333,444	2,858,763
2015	12,399,252	3,089,603
2016	12,994,838	3,024,200
2017	14,025,258	3,742,000
2018	14,025,258	3,868,633
Gjithsej	76,771,391	16,824,794

Burimi: Departamenti i Buxhetit, MEF, 2019

Shtojca 6: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara –
Komuna e Drenasit

	Drenas	
	Te Planifikuara	Te Realizuara
2013	9,616,607	2,454,000
2014	10,982,419	2,811,208
2015	12,118,623	3,418,537
2016	12,118,623	2,403,663
2017	13,141,239	3,064,358
2018	14,477,299	4,395,350
Gjithsej	72,454,810	18,547,116

Burimi: Departamenti i Buxhetit, MEF, 2019

Shtojca 7: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara – Komuna e Obiliq

	Obiliq	
	Te Planifikuara	Te Realizuara
2013	4,530,981	1,122,232
2014	4,567,669	1,358,882
2015	5,046,182	1,231,072
2016	5,226,547	1,231,381
2017	6,061,078	1,521,228
2018	6,851,925	2,164,290
Gjithsej	32,284,382	8,629,085

Burimi: Departamenti i Buxhetit, MEF, 2019

Shtojca 8: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara –
Komuna e Graçanicës

	Graçanicë	
	Te Planifikuara	Te Realizuara
2013	5,708,467	1,919,847
2014	5,557,378	1,677,140
2015	6,083,185	2,341,232
2016	6,028,934	2,183,480
2017	7,134,075	2,894,220
2018	7,484,556	3,566,066
Gjithsej	37,996,595	14,581,985

Burimi: Departamenti i Buxhetit, MEF, 2019

Shtojca 9: Investimet kapitale të planifikuara dhe të realizuara –
Komuna e Shtimes

	Shtime	
	Te Planifikuara	Te Realizuara
2013	4,786,567	5,153,000
2014	5,360,257	5,628,513
2015	5,871,655	5,794,273
2016	5,990,385	6,214,520
2017	6,364,152	6,276,000
2018	6,824,492	6,824,492
Gjithsej	35,197,508	35,890,798

Burimi: Departamenti i Buxhetit, MEF, 2019

